



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

V E N D I M

Nr.05, datë 02.02.2026

MBI

**SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT “I.B.C
TELECOM” SH.P.K., KUNDËR “VENDIMIT PËRFUNDIMTAR TË INSPEKTIMIT”
DHE MASËS ADMINISTRATIVE**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 02 shkurt 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k., kundër Vendimit Përfundimtar të Inspektimit dhe masës administrative

BAZË LIGJORE:

1. Neni 135 i Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
2. Pika 1 e nenit 185 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Pika 3.9 e Rregullores së AKEP nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi administrativ i sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k., i datës 8 dhjetor 2025, i protokolluar në AKEP me nr. 1467/9 prot, datë 09.12.2025.
2. Opinioni i Komisionit Ad Hoc, ngritur me urdhrin e Kryetarit të AKEP nr. 347 prot., datë 15.12.2025, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “I.B.C TELECOM” sh.p.k., kundër Vendimit Përfundimtar të Inspektimit”.
3. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
4. Relacioni shoqërues i Projektvendimit
5. Praktika e plotë e inspektimit.

Si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak:

1. Pas shqyrtimit të ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “I.B.C. Telecom” sh.p.k., kundër vendimit përfundimtar të inspektimit dhe masës administrative, të vendosur nga inspektorët e AKEP (Grupi i Inspektimit), Këshilli Drejtues i AKEP, konstatoi se sipërmarrësi legjitimohet për të paraqitur ankim administrativ referuar nenit 185 të ligjit nr. 54/2024.
2. Sipërmarrësi ankimues ka paraqitur ankimin administrativ brenda afatit të parashikuar në nenin 185 të ligjit nr. 54/2024, si dhe pikës 3.9 të Rregullores së AKEP nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”. Ky ankim i plotëson kushtet formale për pranimin e shqyrtimit të ankimit të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

II. Rrethanat e çështjes:

1. Pranë AKEP janë depozituar gjatë muajit prill 2025, ankesa dhe raportime për interferenca të shkaktuara në zonat e Shkodrës dhe të Lezhës nga sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. (Nr. Ref AKEP-2025-RI-31.1_188) dhe “One Albania” sh.a. (Nr. Ref AKEP-2025-RI-31.1_185).
2. Për verifikimin e ankesave të ardhura në AKEP, ky i fundit, në mënyrë të përsëritur gjatë periudhës prill - qershor 2025, ka autorizuar kryerjen e matjeve për monitorimin e frekuencave, me qëllim identifikimin dhe eliminimin e burimit të interferencave, në

brezin e frekuencave LTE 800 MHz (4G) dhe në brezin e frekuencave GSM 900 MHz, si dhe kryerjen e inspektimit pranë sipërmarrësit ankues i cili përdor antena marrëse DVB-T2, të cilat gjenerojnë frekuenca brenda brezit të dhënë në përdorim sipërmarrësve One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si dhe

- i. kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

3. Së fundmi me shkresën nr. 1476 prot., datë 14.10.2025, Kryetari i AKEP ka autorizuar kryerjen e inspektimit pranë subjektit “I.B.C Telecom” sh.p.k., për periudhën 15-17 tetor 2025. Inspektimi i këtij subjekti u krye me tematikë si më poshtë:

monitorimin e frekuencave, identifikimin dhe eliminimin e burimeve të interferencës dhe inspektimin në ambientet e sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k. për periudhën 15–17 tetor 2025.

4. Grupi i Inspektimit, bazuar në proceverbalin e inspektimit, raportin e monitorimit, shpjegimet dhe provat e dhëna nga subjekti “I.B.C Telecom” sh.p.k., si dhe në praktikat e mëparshme të inspektimit të këtij subjekti (shkresat me nr. 604 prot., datë 08.04.2025 deri nr. 604/8 prot., datë 27.06.2025, si dhe shkresat nr. 1066 prot., datë 27.06.2025 deri nr. 1066/2 prot., datë 02.07.2025), ka konstatuar ndër të tjera se:

- Nga matjet e kryera rezultoi prezencë e një burimi interference e jashtme në zonat e monitoruara për brezin e frekuencave 790–862 MHz dhe 860–960 MHz;
- Grupi i Inspektimit, i ngarkuar për monitorimin e brezit të frekuencave dhe identifikimit të burimit të interferencës, bazuar në matjet e kryera, verifikimet në terren bëri të mundur evidentimin e interferencës dhe ndërmori hapa për të bllokuar dhe hequr nga përdorimi, pajisjet interferuese të markuara me logon e operatorit “I.B.C Telecom” sh.p.k.
- si masë urgjente, grupi i inspektimit ka bllokuar pajisjet DVB-T2 që ishin burim i interferencave të identifikuara dhe në këtë proces Grupi, është asistuar nga teknikët e subjektit “I.B.C Telecom” sh.p.k.
- bazuar në pikën 3/a të nenit 1, të VKM nr. 378/2019, pajisjet marrëse DVB-T2, të tregtuara/furnizuara përdoruesit fundorë nga subjekti “I.B.C Telecom” sh.p.k., nuk përjashtohen nga zbatimi i këtij rregulli teknik, për zotërimin e certifikatës së konfirmimit si pasjisje radio dhe njoftim për regjistrim në AKEP.
- pavarësisht masave të ndërmarra për zëvendësimin e pajisjeve të dëmtuara nga ana e subjektit në vijim edhe të proceseve të mëparshme të inspektimit/monitorimit/komunikimeve shkresore, ka rezultuar se interferencat e shkaktuara nga pajisjet DVB-T2, vijnë të shfaqen, duke degraduar sinjalin e rrjeteve celulare në brezin 800 MHz, që është në përdorim të operatorëve celularë.

5. Bazuar në kompetencat ligjore të Grupit të Inspektimit, referuar neneve 181 e vijues të ligjit nr. 54/2024, është mbajtur procesverbali i inspektimit dhe është marrë “Vendimi Përfundimtar i Inspektimit”, si më poshtë:

- a. dënim administrativ kryesor, në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë, bazuar në nenin 184, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 54/2024. (shkresat nr. 1476/5 prot., dhe nr.1476/6 prot., të datës 05.11.2025).
 - b. dënime administrative plotësuese: tërheqja nga tregu e pajisjeve DVB-T2 HD që nuk janë sipas standardeve të BE (VKM nr. 378/2019) dhe eliminimi i pasojave të shkeljeve brenda një afati të arsyeshëm.
6. Me shkresën nr. 1476/7 prot., datë 05.11.2025, të AKEP, konfirmuar me lajmërim marrje nga shërbimi postar më datë 07.11.2025, subjekti ka marrë dijeni lidhur me vendimin përfundimtar të inspektimit dhe materialet shoqëruese.
7. Në vijim, me shkresën nr. 1476/9 prot., ynë, datë 09.12.2025, subjekti ka depozituar ankimin administrativ kundër vendimit nr. 1476/7 prot., datë 05.11.2025 “Për dënimin me gjobë të shoqërisë “I.B.C Telecom” sh.p.k.”, duke parashtruar:
- *antenat marrëse, objekt inspektimi janë vetëm marrëse të sinjalit, pra nuk është shërbim interaktiv, antenat janë konform direktivave dhe ligjeve shqiptare por edhe atyre evropiane, pajisjet nuk kërkojnë autorizim nga AKEP, subjekti pretendon gjithashtu se për këto pajisje disponon certifikata të konformitetit.*
8. Në mbështetje të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores nr. 46, “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, me urdhër të Kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), nr. 347 prot., datë 15.12.2025, “Për ngritjen e komisionit Ad Hoc për shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k., Komisioni ka shqyrtuar ankimin administrativ të subjektit “I.B.C Telecom” sh.p.k., duke propozuar:
- “Rrëzimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k., kundër vendimit nr. 1476/7 prot., datë 05.11.2025 “Për dënimin me gjobë të shoqërisë “I.B.C Telecom” sh.p.k., si të pabazuar në fakte dhe prova dhe lënien në fuqi të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit dhe sanksionit administrativ të marrë nga Grupi i Inspektimit”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Pasi mori në shqyrtim ankimin administrativ të sipërmarrësit “I.B.C. Telecom” sh.p.k., dhe shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjes së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të këtij procesi inspektimi,

ARSYETON:

1. Në zbatim të Rregullores së AKEP nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”,

Grupi i Inspektimit ka kryer veprimet procedurale duke zhvilluar procedurë inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2. Sa i takon shkeljeve të konstatuara, gjatë kësaj procedure inspektuese, vërehet se sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k., ka kryer shkelje sipas përcaktimeve të neneve 29, 53 dhe 62 të ligjit nr. 54/2024 si dhe të Rregullores të AKEP nr. 48, datë 22.04.2020 “Për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”.
3. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe të pretendimeve të sipërmarrësit “I.B.C Telecom” sh.p.k., pas arsytimit dhe akteve të paraqitura nga Grupi i Inspektimit si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, konstatohet se vendimi përfundimtar është marrë nga Grupi i Inspektimit në mbështetje dhe në përputhje me procedurën inspektuese.
4. Sipas kuadrit ligjor në fuqi, Vendimi Përfundimtar i Inspektimit është akti që mbyll një procedurë inspektimit dhe nxirret nga grupi i inspektimit pas nënshkrimit të procesverbalit.

Në rastin konkret kur janë konstatuar shkelje, grupi i inspektimit bazuar edhe në procesverbalin e inspektimit dhe administrimin e shpjegimeve, provave dhe kundërshtimeve të dhëna nga subjekti i inspektimit ka përpiluar vendimin përfundimtar të inspektimit dhe ia ka dërguar atë subjektit ankimues brenda afateve ligjore, duke përcaktuar edhe masat administrative.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në zbatim të pikës 1, të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të paraqitur nga shoqëria “I.B.C. Telecom” sh.p.k.
2. Lënien në fuqi të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr. 1476/5 prot., datë 05.11.2025 dhe nr. 1476/6 prot., datë 05.11.2025.
3. Ky Vendim t’i njoftohet shoqërisë “I.B.C. Telecom” sh.p.k.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet akim në gjykatë brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka